

## AUTORITETI I ÇERTIFIKIMIT

### E DREJTA CIVILE, PENALE, LEGJISLACIONI TREGTAR DHE E DREJTA E PUNËS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

#### Teza me Përgjigjet - 2014

#### **SEKSIONI I PARË: PYETJE ME ALTERNATIVA ( 1 PIKË SECILA)**

##### **1. Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare kërkon nga shoqëritë të:**

- A. Kenë një faqe të tyre të internetit, pasi ndryshe nuk regjistrohen
- B. Të kenë një faqe interneti, që të mund të regjistrohen si shoqëri aksionare
- C. **Ne rastet kur kane hapur faqe interneti duhet te publikojne atje të gjitha të dhënat që kërkon nga ligji;**
- D. Edhe kur kane faqe interneti, nuk janë të detyruara të pasqyrojnë asnjë të dhënë, pasi të dhënat e kërkuara nga ligji, afishohen tanimë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

##### **Përgjigja e saktë: alternativa C**

##### **2. Në përputhje me LTShT, parimisht, ortaku i kufizuar në një shoqëri komandite përgjigjet për detyrimet që shoqëria komandite krijon ndaj të tretëve:**

- A. Nuk përgjigjet
- B. **Përgjigjet deri në vlerën e kontributit të nënshkruar**
- C. Përgjigjet në mënyrë të pakufizuar
- D. Përgjigjet si të ishte ortak i pakufizuar

##### **Përgjigja e saktë: alternativa B**

**3. Kryetari i këshillit të administrimit:**

- A. nuk mund të jetë administrator;
- B. mund të jetë administrator, nuk ka asnjë ndalim;
- C. mund të jetë administrator, por në këtë rast duhet që zëvendëskryetari të jetë jo administrator;
- D. derisa zgjidhet midis anëtarëve të Këshillit mund të jetë administrator ose jo.

**Përgjigja e saktë: alternativa A**

**4. Zmadhimi i autorizuar i kapitalit:**

- A. bëhet me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- B. bëhet me vendim të administratorët;
- C. nuk ka limit për zmadhimin e kapitalit;
- D. asnjë alternativat më sipër;

**Përgjigja e saktë: alternativa B**

**5. Kalimi i aktiveve dhe pasiveve nga shoqëria që përthithet tek shoqëria përthithëse realizohet:**

- A. me përfundimin e projekt marrëveshjes;
- B. me regjistrimin e projekt marrëveshjes për bashkim;
- C. njoftimin e bashkimit të shoqërisë në QKR;
- D. nga momenti i marrjes së vendimit të bashkimit nga shoqëritë përkatëse.

**Përgjigja e saktë: alternativa C**

**6. Dsipozitat në lidhje me bashkimin:**

- A. zbatohen ndaj të gjitha formave të shoqërive;
- B. zbatohen ndaj shoqërive të personit;
- C. zbatohen ndaj shoqërive të kapitalit;
- D. zbatohen si ndaj shoqërive të personit ashtu dhe ndaj atyre të kapitalit.

**Përgjigja e saktë: alternativa C**

**7. Trashigimia ligjore zbatohet kur:**

- A. Trashigimlënësi është nën moshën 18 vjeç
- B. Trashigimtari nuk ka zotësi për të vepruar
- C. **Testamenti është shpallur i pavlefshëm**
- D. Testamenti është bërë me akt noterial

**Përgjigja e saktë: alternativa C**

**8. Kur personi i siguruar ka mbi 10 vjet sigurim, përfiton të ardhura për sëmundje (të vërtetuara me raport mjekësor) në masën:**

- A. 60% të të mesatares ditore të bazës së vlerësueshme të vitit të fundit kalendarik
- B. 70% të të mesatares ditore të bazës së vlerësueshme të vitit të fundit kalendarik
- C. 75% të të mesatares ditore të bazës së vlerësueshme të vitit të fundit kalendarik
- D. **80% të të mesatares ditore të bazës së vlerësueshme të vitit të fundit kalendarik**

**Përgjigja e saktë: alternativa D**

**9. Në rastin e procedurës së falimentimit:**

- A. komiteti i kreditorëve përfaqëson vetëm kreditorët e pasiguruar;
- B. komiteti i kreditorëve caktohet nga gjykata pas mbledhjes së parë të kreditorëve;
- C. **anëtarë të komitetit të kreditorëve mund të emërohen edhe persona që nuk janë kreditorë;**
- D. komiteti i kreditorëve nuk duhet të përfaqësojë kreditorët e shumave të vogla.

**Përgjigja e saktë: alternativa C**

**10. Mos njohja e ligjit që dënon veprën penale (*ignorantia legis non excusat*):**

- A. nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale;
- B. përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale;
- C. përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale, veç rasteve kur mosnjohja është objektivisht e paevitueshme;
- D. **nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale, veç rasteve kur mosnjohja është objektivisht e paevitueshme.**

**Përgjigja e saktë: alternativa D**

## **SEKSIONI I DYTË:**

### **1. Shpjegoni konceptin e hetimeve të posaçme dhe subjektet që mund ta inicojnë atë. (3 pikë)**

#### **Përgjigja Pyetja Nr.1**

1. Hetimet e posaçme konsistojnë në një instrument të ofruar nga LTShT për të kërkuar llogari mbi mbarëvajtjen e shoqërisë nga ana e kreditorëve dhe ortakëve të pakicës. Sipas nenit 91 të LTShT, Asambleja e përgjithshme mund të vendosë për nisjen e një hetimit të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm duhet ushtruar brenda 3 vjetësh nga data e regjistrimit të shoqërisë, kur hetimi ka si objekt parregullsitë gjatë themelimit dhe brenda 3 vjetësh nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare. **(1.5 pike)**
2. **Subjektet që e inicojnë hetimin e posaçëm:**
  1. Asambleja e përgjithshme (ose vetë, ose me kërkesë të cdo kreditori, ose me kërkesë të ortakëve të pakicës)
  2. Gjykata (me kërkesë të kreditorëve, apo të ortakëve të pakicës - që zotërojnë tëpaktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme, apo një vlerë më të vogël, të parashikuar në statut) **(1.5 pike)**

### **2. Cilat arsye përmend LTShT si shkaqe të rëndësishme, që përlligjin kërkesën për përjashtimin e ortakut? (3 pikë)**

#### **Përgjigja Pyetja Nr.2**

**Shkaqet që përlligjin kërkesën për përjashtimin e ortakut janë:**

1. Mosshlyerja e kontributit **(0.5 pikë)**
2. Ortaku i shkakton dëme shoqërisë apo ortakëve të tjerë, me dashje, apo pakujdesi të rëndë; **(0.5 pikë)**
3. Me dashje, apo pakujdesi të rëndë shkel statutin, apo detyrimet e përcaktuara në ligj **(0.5 pikë)**
4. Përfshihet në veprime të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve të ortakërisë **(0.5 pikë)**
5. Me veprimet e tij dëmton ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë **(0.5 pikë)**

Në përgjigje duhet theksuar, që lista e shkaqeve e dhënë nga LTShT nuk është “*numerus clausus*” ose një listë shterruese, por vetëm ilustruese (**Neni 102 i LTShT “përjashtimi i ortakut”** – Konsiderohen shkaqe të arsyeshme, por pa u kufizuar në to, rastet... ) **(0.5 pikë)**

### 3. Si thirret Asambleja e Përgjithshme në shoqëritë aksionere me një nivel? (3 pikë)

#### Përgjigja Pyetja Nr.3

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. (0,5 pikë)

2. Ky njoftim duhet të përmbajë, gjithashtu:

a) emrin e shoqërisë, selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;

b) një sqarim të hollësishëm të procedurave, që duhet të ndiqen nga aksionarët, për të marrë pjesë dhe votuar në asamble, e cila duhet të përfshijë:

i) të drejtat e aksionarëve, sipas nenit 139 të këtij ligji;

ii) procedurat e votimit me prokurë, formularë të posaçëm, për t'u përdorur gjatë votimit me prokurë dhe mjetet elektronike, me të cilat shoqëria do të pranojë njoftimin e përfaqësuesve të autorizuar;

iii) procedurat për votimin, me mjete elektronike apo me korrespondencë;

c) informacion për vendin e mënyrat për të marrë në formë të plotë dokumentet dhe projektvendimet

ç) adresën e faqes së internetit të shoqërisë, ku mund të merret informacioni i përcaktuar në këtë nen.

Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, së bashku me rendin e ditës, vendosen edhe në faqen e internetit të shoqërisë. **(1 pikë, ku secili informacion mund të vlerësohet me 0,2 pikë)**

3. 21 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, përfshirë këtu ditën e mbledhjes, shoqëria duhet t'u vërë në dispozicion aksionarëve në faqen e saj në internet, të paktën informacionin vijues:

a) informacionin sipas pikave 1 e 2 të këtij neni;

b) numrin total të aksioneve dhe të drejtave të votës që u përkasin këtyre aksioneve në datën e njoftimit të thirrjes së mbledhjes, përfshirë shumat totale për çdo kategori aksionesh, kur kapitali i shoqërisë ndahet në dy apo më shumë kategori aksionesh;

c) çdo dokument që do t'i vihet në dispozicion asamblesë së përgjithshme. (1 pikë ku secili informacion mund të vlerësohet me 0,2 pikë)

4. Në rastin kur shoqëria aksionare ka shumë aksionarë, thirrja e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme mund t'u njoftohet aksionarëve edhe nëpërmjet botimit të informacioneve si më sipër në një gazetë të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin. **(0.5 pikë)**

**4. Cili është parashikimi që bën ligji për kostot e themelimit të një sh.a.? (3 pikë)**

**Përgjigja Pyetja Nr. 4**

1. Themeluesit mund t'i kërkojnë shoqërisë rimbursimin e kostove të themelimit, (1 pikë) deri në vlerën më të lartë, të parashikuar në statut.

2. Kostot e themelimit u paguhen themeluesve nga fitimet, që realizon shoqëria. (1 pikë)

3. Përveç se kur parashikohet ndryshe në statut, aksionarët mund të vendosin që rimbursimi i kostove të themelimit të këtë përparësi gjatë shpërndarjes së fitimeve. (1 pikë)

**5. Cila është shumica e kërkuar për miratimin e projekt-marrëveshjes së bashkimit nga asambleja e përgjithshme? (3 pikë)**

**Përgjigja Pyetja Nr. 5**

Duke iu referuar ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, shumica e kërkuar për miratimin e projekt-marrëveshjes së bashkimit duhet të plotësojë kushtet e nenit 145(1) dhe 144 (1). **(0,5 pikë)**

Në këtë kuptim, nëse statuti nuk parashikon një shumicë më të lartë, vendimi merret me shumicë të kualifikuar e cila kërkon praninë e atyre aksionarëve që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e aksioneve me të drjetë votë dhe vendimi merret me  $\frac{3}{4}$  e aksionarëve të pranishëm. (1 pikë për kuorumin dhe 1 pikë për shumicën).

Kur marrëveshja prek të drejtat e një kategorie të caktuar aksioanrësh atëherë që marrëveshja të jetë e vlefshme, duhet të merret edhe miratimi i kësaj kategorie. **(0.5 pikë)**

**6. Cilët janë subjektet që kanë detyrimin për t'u regjistruar pranë QKR? (3 pikë)**

**Përgjigja Pyetja Nr. 6**

Sipas ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, subjektet që kanë detyrimin për t'u regjistruar në QKR janë:

1. Personat fizikë që ushtrojnë veprimtari tregtare **(0.5 pikë)**
2. shoqëritë e thjeshta sipas dispozitave të KC **(0.5 pikë)**
3. shoqëritë tregtare **(0.5 pikë)**
4. degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja **(0.5 pikë)**
5. shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit. **(0.5 pikë)**

6. shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjelltë **(0.5 pikë)**

**7. Cili është autoriteti që përcakton pagën referuese për efekt përfitimi nga skema e sigurimit shoqëror suplementar si funksionar kushtetues, nëse funksioni apo detyra në momentin e lindjes së të drejtës nuk ekziston? (3 pikë)**

**Përgjigja Pyetja Nr. 7**

- a. Personat që kryejnë funksione kushtetuese si dhe disa kategori funksionarësh politikë në administratën publike paguajnë kontribute shtesë të cilat depozitohen në fondin e sigurimit shoqëror suplementar. Ky kontribut llogaritet në funksion të marrjes së pensionit suplementar në të ardhmen. **(1 pikë)**
- b. Në kuadër të organizimit shtetëror kushtetues, organe dhe funksione të një periudhe të caktuar mund të ndryshojnë më vonë, kështu që një funksion kushtetues mund të mos ekzistojë më në momentin kur funksionarit nga pikëpamja e moshës i lind e drejta për të kërkuar pension suplementar. **(1 pikë)**
- c. Në këto kushte duhej që një autoritet qendror të përcaktojë pagën referuese për efekt përfitimi nga skema e sigurimit shoqëror suplementar. Duke qenë se Departamenti i Administratës Publike është një autoritet i cili veç të tjerash përcakton edhe nivelet e pagave sipas pozicioneve dhe kategorive në administratën shtetërore, është DAP që përvakton edhe pagën referuese në rastin e cituar. **(1 pikë)**

**8. Cilët janë përbërësit e pensionit dhe si llogaritet aktualisht shuma e përgjithshme e pensionit? (3 pikë)**

**Përgjigja Pyetja Nr. 8**

- a. Pensioni përbëhet nga shuma bazë dhe një shtesë. Shuma bazë duhet të sigurojë standardin minimal të jetesës, ndërsa shtesa është 1% për çdo vit sigurimi, shumëzuar me mesataren e bazës së vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur me pagesën e kontributeve. **(1 pikë)**
- b. Në përfundim shuma e përgjithshme e pensionit është jo më shumë se dyfishi i shumës bazë, ose sa 75% e pagës mesatare neto të tre vjetëve rresht në 10 vitet e fundit të punës së personit të siguruar. **(1 pikë)**
- c. Masa e cila është më e vogël nga këto llogaritje është masa e pensionit që do të përfitoje personi. **(1 pikë)**

**9. Cili është shkaku i hapjes së procedurës së falimentimit? (3 pikë)**

**Përgjigja Pyetja Nr. 9**

Shkaku i hapjes së procedurës së falimentimit është gjendja e paaftësisë paguese në rastin e personave fizikë **(1,5 pikë)** dhe mbingarkesa me borxhe në rastin e një personi juridik **(1,5 pikë)**.

**10. Në cilat raste seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit? (3 pikë)**

**Përgjigja Pyetja Nr. 10**

Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit kur vërtetohet se pasuria e debitorit është e pamjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të procedurës së falimentimit. (3 pikë)

**11. Kush legjitimohet për thirrjen e mbledhjes së kreditorëve? (3 pikë)**

**Përgjigja Pyetja Nr. 11**

Mbledhja e kreditorëve thirret kur kërkohet nga:

- a) administratori i falimentimit; (1 pikë)
- b) komiteti i kreditorëve; (1 pikë)
- c) kreditorët e falimentimit, pretendimet e të cilëve, të marra së bashku, sipas vlerësimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit, përbëjnë të paktën një të pestën e shumës së pretendimeve të të gjithë kreditorëve të falimentimit. (1 pikë)

**12. Flisni në lidhje me subjektet e posaçëm që i nënshtrohen Ligjit 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, (i ndryshuar). (3 pikë)**

**Përgjigja Pyetja Nr. 12**

Në kuptim të këtij ligji, “Subjekt” është personi fizik ose juridik që vendos marrëdhënie biznesi me klientë, gjatë veprimtarisë së tij normale apo si pjesë e veprimtarisë tregtare ose profesionale të tij., ndërsa “Person” konsiderohen individët, personat fizikë tregtarë dhe personat juridikë.”

Neni 3 i ligjit parashikon se subjekte që i nënshtrohen këtij ligji janë:

- a) subjektet bankare, si dhe çdo subjekt tjetër që licençohet apo mbikëqyret nga Banka e Shqipërisë;
- b) subjektet financiare jobanka;
- c) zyrat e këmbimeve valutore;
- ç) shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre;
- d) shërbimet postare që kryejnë shërbime pagesash;
- dh) Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale;
- e) bursat dhe çdo subjekt tjetër (agjent, broker, shtëpi brokerimi etj.), që ushtron veprimtari për emetimin, këshillimin, ndërmjetësimin, financimin dhe çdo shërbim tjetër që ka lidhje me tregtimin e titujve;



ë) shoqëritë që merren me sigurimin e jetës ose risigurimin, agjentët apo ndërmjetësit e tyre, si dhe fondet e pensionit;

f) Autoriteti Shtetëror Përgjegjës për Administrimin dhe Shitjen e Pronës Publike dhe çdo person tjetër juridik publik që kryen veprime juridike lidhur me tjetërsimin dhe dhënien në përdorim të pronës shtetërore, ose që kryen evidentimin, transferimin apo tjetërsimin e pronës shtetërore;

g) lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet, të çfarëdo forme;

gj) avokatët, noterët dhe përfaqësues të tjerë ligjorë, profesionet e rregulluara, që ofrojnë shërbimet e konsulencës financiare kur përgatisin ose kryejnë transaksione për klientët e tyre për veprimtaritë e mëposhtme:

i) kalimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme, administrimin e parave, të letrave me vlerë ose të aseteve të tjera;

ii) administrimin e llogarive bankare;

iii) administrimin e pjesëve të kapitalit që do të përdoren për themelimin, funksionimin ose administrimin e shoqërive tregtare;

iv) krijimin, funksionimin ose administrimin e personave juridikë;

v) marrëveshjet ligjore, shitblerjen e aksioneve ose të pjesëve të kapitalit të shoqërive aksionare dhe transferimin e veprimtarive tregtare;

h) agjentët e pasurive të paluajtshme, sipas kuptimit të përcaktuar në legjislacionin shqiptar për këtë kategori, kur përfshihen në transaksione për klientët e tyre, që lidhen me blerje ose shitje të pasurive të paluajtshme;

i) ekspertët kontabël të autorizuar të pavarur, kontabilistët e miratuar të pavarur dhe zyrat e konsulencës financiare;

j) çdo person fizik ose juridik, përveç atyre të specifikuar më sipër, të cilët merren me:

i) administrimin e aseteve të të tretëve/drejtimin e veprimtarive të lidhura me to;

ii) tregtimin e mjeteve motorike;

iii) ndërtimet;

iv) biznesin e metaleve dhe të gurëve të çmuar;

v) agjencitë e udhëtimit;

vi) marrëveshjet dhe garancitë financiare;

vii) shitblerjen e veprave të artit apo shitblerjen me ankand të sendeve me vlerë 1 500 000 lekë ose më shumë;

viii) sigurimin dhe administrimin e parasë fizike ose të letrave me vlerë lehtësisht të konvertueshme, në emër të personave të tretë;

ix) veprimtaritë e speditimit dhe të transportit.

### **13. Trajto parimin e mosnjohjes së ligjit penal. (3 pikë)**

#### **Përgjigja Pyetja Nr. 13**

Mosnjohja e ligjit që dënon veprën penale, nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale, veç rasteve kur mosnjohja është objektivisht e paevitueshme. Kodi i ri Penal parashikon përjashtimin nga parimi i përgjithshëm kur mosnjohja e normës penale është objektivisht e

paevitueshme, personi nuk ka përgjegjësi penale. Psh. kur personi ka qenë jashtë shtetit, ose ka qenë i shtruar në spital në gjendje të rëndë, në kohën që është miratuar ligji etj.. Mosnjohja e ligjit ndryshe zgjidhet për shtetasin e thjeshtë, që nuk ka pasur mundësi objektive të njihet me normën penale, ndryshe për një kuadër apo nëpunës kur është fjala për norma penale që i përkasin detyrës apo profesionit të tij.

#### **14. Flisni për rastet kryerjes së veprës penale nga më shumë se një person dhe përgjegjësia e secilit. (3 pikë)**

##### **Përgjigja Pyetja Nr. 14**

Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre. Bashkëpunëtorë për kryerjen e veprës penale quhen: organizatorët, ekzekutorët, shtytësit dhe ndihmësit. Organizatorë quhen ata persona që organizojnë dhe drejtojnë veprimtarinë për kryerjen e veprës penale. Ekzekutorë janë personat që kryejnë veprime të drejtpërdrejta për realizimin e veprës penale. Shtytës quhen personat që nxisin bashkëpunëtorët e tjerë për kryerjen e veprës penale. Ndihmës quhen personat që me këshilla, udhëzime, dhënie mjetesh, largim të pengesave, dhënie të premtimit për fshehjen e bashkëpunëtorëve, të gjurmëve apo të sendeve që rrjedhin nga vepra penale, ndihmojnë për kryerjen e saj.

Organizatorët, shtytësit dhe ndihmësit kanë përgjegjësi si edhe ekzekutorët për veprën penale të kryer prej tyre. Në caktimin e dënimit për bashkëpunëtorët, gjykata duhet të mbajë parasysh shkallën e pjesëmarrjes së secilit dhe rolin e luajtur në kryerjen e veprës penale.

#### **15. Kufizimet e së drejtës së pronësisë. (4 pikë)**

##### **Përgjigja Pyetja Nr. 15**

E drejta e pronësisë mund të kufizohet nga norma ligjore të nevojshme, vetëm për t'i detyruar të tjerët të kryejnë ose mos të kryejnë një veprim të caktuar në lidhje me sendin. Kufizimet e së drejtës së pronësisë së njohura më ligj janë : **(1 pikë)**

1. Detyrimi për regjistrimi i sendeve të paluajtëshme **(1 pikë)**
2. Vendosija e servitutit ligjor **(1 pikë)**
3. Shpronësimi për interesa publik **(1 pikë)**

#### **16. Karakteristikat e fitimit të pronësisë me mirëbesim. (4 pikë)**

##### **Përgjigja Pyetja Nr. 16**

Jemi përpara fitimit të pronësisë me mirëbesim në rastin kur një person, në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë, ka fituar kundrejt shpërblimit me mirëbesim një send të luajtshëm, bëhet pronar i këtij sendi edhe sikur tjetërsuesi të mos ishte disponues i tij. Për fitimin e pronësisë me mirëbesim duhen të konstatohen këto kushte: **(2 pikë)**

1. Sendi duhet të jetë i luajtshëm **(0,5 pikë)**
2. Fitimi i pronësisë duhet të jetë bërë me kontratë të dyanshme (me kundërshpërblim) **(0,5 pikë)**
3. Personi që ka fituar sendin duhet të jetë në mirëbesim **(0,5 pikë)**
4. Sendi nuk duhet të jetë i vjedhur **(0,5 pikë)**

**17. Si garantohet barazia gjinore në shpërblim? Cilat konsiderohen kritere jodiskriminuese në përcaktimin e shpërblimit? (4 pikë)**

**Përgjigja Pyetja Nr. 17**

- a. Sipas Kodit të Punës punëdhënësi jep të njëjtën pagë si për gratë dhe për burrat të cilët kryejnë punë me vlerë të barabartë. **(1 pikë)**

Diferencat në pagë pavarësisht gjinisë bazohet në kritere objektive si :

- Cilësia dhe sasia e punës **(1 pikë)**
- Vjetërsia në punë **(1 pikë)**
- Kualifikimi profesional **(1 pikë)**

**18. Si ndërtohet përgjegjësia e ortakëve të kufizuar në shoqëritë komandite? (6 pikë)**

**Përgjigja Pyetja Nr. 18**

1. **Rregulli i përgjithshëm:** Në një shoqëri komandite përgjegjësia e ortakut të kufizuar ndërtohet në mënyrë të ndryshme nga ajo e ortakut të pakufizuar. Përgjegjësia e tij është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të nënshkruar, që do të thotë, deri në një vlerë monetare, të përcaktuar në statutin e shoqërisë. Kur ortakut i kufizuar e ka shlyer të gjithë kontributin e nënshkruar, ai nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë. **(Neni 62 i LTShT “Përgjegjësia e ortakut të kufizuar” – 1 Ortaku i kufizuar përgjigjet personalisht ndaj kreditorëve të shoqërisë komandite deri në vlerën e kontributeve të pashlyera. Ortaku i kufizuar nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë, në rastin kur i ka shlyer të gjitha kontributet e tij. 3. Marrëveshjet ndërmjet ortakëve, që përjashtojnë ortakun e kufizuar nga detyrimi për të shlyer kontributet, apo që shtyjnë afatin e shlyerjes së këtyre kontributeve, nuk prodhojnë efekte ndaj kreditorëve). (1 pike)**
2. **Neni 60 i LTShT “Përballimi i humbjeve” – Ortaku i kufizuar i përballon humbjet e shoqërisë deri në vlerën e pjesës së tij në kapital dhe vlerën e kontributeve ende të pashlyera” (1 pike)**
3. **Neni 62 i LTShT “Përgjegjësia e ortakut të kufizuar 2. Rritja e paregjistruar e një kontributi të regjistruar prodhon efekte ndaj kreditorëve, vetëm nëse shoqëria ka njoftuar kreditorin për këtë rritje, ose nëse rritja është publikuar në mënyrë të zakonshme. 4. Zvogëlimi i kontributeve nuk prodhon efekte ndaj kreditorëve, për sa kohë ky zvogëlim nuk është regjistruar, me përjashtim të rastit kur kreditori kishte dijeni për këtë zvogëlim.**

Zvogëlimi i kontributeve, edhe nëse është i regjistruar nuk prodhon efekte ndaj kreditorëve, detyrimet e të cilëve kishin lindur përpara regjistrimit të këtij zvogëlimi.

**(1 pike)**

4. Në rastin kur ortakut të kufizua ri kthehet kontributi pjesërisht, apo tërësisht, përgjegjësia e tij ripërtërihet, për atë sa është kontributi i kthyer. **(Neni 62 i LTShT “Përgjegjësia e ortakut të kufizuar** 5. Nëse shoqëria i kthen ortakut të kufizuar kontributet e dhëna, ortaku i kufizuar përgjigjet ndaj kreditorëve, sikur kontributi i tij të mos ishte paguar ndonjëherë. I njëjti parim zbatohet edhe në rastet kur ortaku i kufizuar i shoqërisë komandite tërheq një pjesë të fitimit, dhe pjesa e tij në shoqëri bëhet më e vogël, se kontributi i marrë përsipër. 6. Ortaku i kufizuar nuk është i detyruar të kthejë fitimet, të cilat i ka marrë në mirëbesim, në bazë të pasqyrave financiare, të përgatitura në mirëbesim. **(1 pike)**
5. **Rregulla të veçanta:** personi që hyn në shoqëri në cilësinë e ortakut të kufizuar përgjigjet për detyrimet që janë krijuar në emër të shoqërisë, para se kjo të regjistrohet në regjistrin tregtar **(neni 65 i LTShT “Përgjegjësia para regjistrimit”** – Kur themeluesit e shoqërisë komandite marrin përsipër detyrime për veprimtarinë tregtare të shoqërisë, përpara se shoqëria të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, ortaku i kufizuar, që pranon të marrë përsipër këto detyrime, përgjigjet si të ishte ortak i pakufizuar, me përjashtim të rastit, kur provon se pala e tretë kishte dijeni për kufizimet e përgjegjësive të tij, apo në bazë të rrethanave të qarta, nuk kishte si të mos ishte në dijeni) **(1 pike)**
6. Përgjegjësia nga perceptimi i gabuar i cilësive ligjore. **(neni 64 i LTShT “përgjegjësia nga perceptimi i gabuar i cilësive ligjore”** - Ortaku i kufizuar përgjigjet si të ishte i pakufizuar nëse emri i tij është përfshirë, me pëlqimin e tij në emrin e regjistruar të shoqërisë. 2. Ortaku i kufizuar, që ka lidhur marrëveshje me një palë të tretë, në cilësinë e agjentit të autorizuar të shoqërisë, por pa u cilësuar si i tillë, përgjigjet për këtë veprim si të ishte ortak i pakufizuar, me përjashtim të rasteve, kur provon se i treti kishte dijeni për faktin se ortaku vepronte si agjent i autorizuar apo në bazë të rrethanave të qarta nuk kishte si të mos ishte në dijeni. 3. Ortaku i kufizuar përgjigjet për detyrimet e shoqërisë si të ishte ortak i pakufizuar nëse ai vepron në kundërshtim me parashikimin e fjalisë së dytë të pikës, 1, neni 59 i këtij ligji (kryen veprime administrimi). **(1 pike)**

## **19.Tagrat e asamblesë së përgjithshme të ortakëve dhe procesi i vendimmarrjes (kuorumi dhe votimi). (6 pikë)**

### **Përgjigja Pyetja Nr. 19**

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- i) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- k) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute **(1.5 pike)**

### **1. Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë një shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji. **(1.5 pike)**

### **2. Vendimmarrja**

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. 2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji (tagrat që janë dhënë më sipër), asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës. **(1.5 pike)**

### **3. Votimi**

Cdo kuotë jep të drejtën e një vote. Statuti mund të parashikojë për ortakët që nuk janë të pranishëm mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër, apo nga një person i tretë; Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme; **(1.5 pike)**

**20.Çfarë kompetencash ka Këshilli Mbikëqyrës tek shoqëria aksionere me dy nivele? (6 pikë)**

**Përgjigja Pyetja Nr. 20**

Këshilli Mbikëqyrës ka këto kompetenca:

Neni 154 pika 1:

- b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
- c) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- ç) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrimit (mbikëqyrës) për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
- ë) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i këshillit mbikëqyrës, përmendur në shkronjën "e" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
- f) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre;
- g) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;
- i) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut. **(5 pikë nga ku cdo kompetencë vlerësohet me 0,5 pikë)**

Në rastet e parashikuara nga ligji, këshilli (mbikëqyrës) duhet të thërrasë menjëherë asamblenë e përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të

tjera të nevojshme e të përshtatshme. (1 pikë)

**21. Cilët janë subjektet që mund të kërkojnë shfuqizimin e vendimeve të administratorëve? (6 pikë)**

**Përgjigja Pyetja Nr. 21**

1. Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës kompetente shfuqizimin e vendimeve të administratorëve e, sipas rastit, të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës, kur këto vlerësohen si shkelje të rënda të ligjit ose të statutit. (1 pikë)

2. Aksionarët, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë apo një vlerë më të vogël, të parashikuar në statut. (1 pikë)

Si dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit të regjistruar, të cilët mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë si më sipër. (1 pikë)

Aksionarët apo kreditorët e shoqërisë, të përcaktuar me sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë padi drejtpërdrejt përpara gjykatës përkatëse për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. (1 pikë)

Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e aksionarëve apo e kreditorëve vlerësohet e refuzuar. (1 pikë)

Në këto kushte pas kalimit të 60 ditëve ata kanë të drejtë t'i drejtohen vetë gjykatës drejtpërdrejtë. (1 pikë)

**22. Cilat janë rregullat që ligji përcakton lidhur me emërtimin e subjektit? (6 pikë)**

**Përgjigja Pyetja Nr. 22**

Së pari, emërtimi i subjektit të ri nuk duhet të jetë i njëjtë ose i ngjashëm me emrat e subjekteve të regjistruara më parë. (0.5 pikë)

Nuk lejohet regjistrimi i emrave në trajtën e shquar (0.5 pikë), shkurtimet përkatëse të shteteve (0.5 pikë), qyteteve (0.5 pikë), krahinave gjeografike (0.5 pikë) organizatave ndërkombëtare, fetare (0.5 pikë) ose institucioneve të pushtetit qendror apo vendor, pa shtesa dalluese (0.5 pikë) ose me emra, që janë në kundërshtim me rendin e moralin publik apo me dispozitat urdhëruese të ligjit. (0.5 pikë)

Regjistrimi i emrit të subjektit bëhet sipas rregullit të përparësisë (1 pikë)

Po ashtu, ligji njuh të drejtën për rezervimin ne emrit kundrejt pagimit të tarifës përkatëse. (1 pikë).

**23.**Për çfarë duhet të shprehet veçanërisht eksperti i pavarur i licencuar i caktuar gjatë bashkimit? **(6 pikë)**

**Përgjigja Pyetja Nr. 23**

Eksperti i pavarur i licencuar caktohet nga përfaqësuesit e shoqërive që marrin pjesë në bashkim për të vlerësuar kushtet e bashkimit. **(1 pikë)**

Për realizimin e këtij qëllimi eksperti hartojnë një raport me shkrim të cilin duhet të deklarojë ndër të tjera, nëse, sipas mendimit të tyre, raporti i këmbimit të aksioneve/kuotave është i drejtë dhe i arsyeshëm **(1 pikë)**

Veçanërisht eksperti duhet të shprehet mbi:

a) për metodën ose metodat e përdorura për të arritur në raportin e propozuar të këmbimit të aksioneve/kuotave; **(1 pikë)**

b) nëse kjo metodë apo këto metoda janë të përshtatshme për rastin në fjalë, duke treguar vlerat e arritura përmes përdorimit të metodës/metodave dhe të japin një mendim për rëndësinë relative të secilës

metodë, për të arritur në vlerën e vendosur; **(2 pikë)**

c) për vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur. **(1 pikë)**

**Suksese!**